



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2942 Prot.

Tiranë, më 29. 5. 2020

URDHËR

Nr. 125, datë 29. 5. 2020

PËR

SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 101, DATË 01.04.2020 "PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE DHE JO PUBLIKE",

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 101, datë 01.04.2020 "Për mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jo publike", shfuqizohet.
2. Institucionet arsimore publike dhe jopublike të marrin masa për respektimin rigoroz të protokolleve dhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe urdhrin nr. 333., datë 20.05.2020 "Për miratimin e udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik për "Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmerren institucionet e kopshteve dhe çerdheve"" dhe urdhrin nr. 351., datë 29.05.2020 "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjen së COVID-19" të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore parashkollore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

BESA SHAHINI

